



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:167339

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05541617

P.nr. 2350/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, me Bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, duke vendosur, sipas detyrës zyrtare, në çështjen penale ndaj të pandehurit I.S për shkak te veprës penale “Vjedhja e Pyllit” nga neni 349 par. 2 te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 5144/2020 të datës: 27.11.2020, jashtë seance, në mbështetje të nenit 357 par.1 nen par 1.3 të KPPR-ës, me datë: 04.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 5144/2020 të datës: 27.11.2020, si dhe,
- II. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit I.S nga babai I dhe nena E, e gjinisë Mehmeti, i lindur me “data e lindjes” ne “vendlindje”, me vendbanim ne rrugën “rruga” ne Prishtine, me nr. personal “letërnjoftim”, i martuar, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës
- III. Për shkak se nuk është plotësuar aktakuza PP/II.nr. 5144/2020 të datës: 27.11.2020.
- IV. Pala e dëmtuar Agjencioni Pyjor i Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.
- V. Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 5144/2020 të datës: 27.11.2020, ndaj të pandehurit I.S për shkak te veprës penale “Vjedhja e Pyllit” nga neni 349 par. 2 te KPRK-se.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata ka bere shqyrtimin e aktakuzës, PP/II.nr. 5144/2020 të datës: 27.11.2020, ndaj të pandehurit I.S për shkak te veprës penale “Vjedhja e Pyllit” nga neni 349 par. 2 te KPRK-se. Pas shqyrtimit të saj me vëmendje, ka konstatuar se, aktakuza përmban te

meta procedurale, nga fakti se nuk dihet sipërfaqja e pyllit ku dyshohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet ne barre sipas aktakuzës, pasi qe sipas Ligjit nr. 08/L-137 Për Pyjet i Republikës Se Kosovës, ashtu siç parashihet me dispozitën ligjore te nenit 3 par. 1 te këtij ligji, ku citohet se: *“Pyll është sipërfaqja e mbuluar me drunjt pyjor, më të lartë se pesë (5) metra në fazën e tyre të pjekurisë, në formë të grumbullit pyjor ose grupeve të vogla të drunjtëve, me kurorë dendësi më të madhe se 10%, e cila gjithashtu përfshinë bashkësinë biekologjike, që është më e madhe se 50 ari”* andaj ne rastin konkret nuk dihet sipërfaqja pyjore ne atë mënyrë qe e quajmë sipërfaqe pyjore , si dhe ne aktakuzën e lartcekur thuhet se i akuzuari ka kryer veprën penale “Vjedhje pylli” nga neni 349 par. 2 te KPRK-se, e qe realisht sipas kësaj dispozite dhe paragrafi citohet se: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim që drunjtë e prerë të shiten; nëse sasia e drunjtve të prerë është mbi pesë (5) metra kub; ... kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.”* Qe do te thotë se sipas dispozitivit te aktakuzës nuk kane kaluar pesë (5) metra kub te cilat dyshohet se janë vjedhur.

Andaj, Gjykata konstaton qe sipas shkresave te lendes nuk rezulton se janë përmbushur obligimet ligjore nga ana e prokurorisë, fillimisht nuk dihet sipërfaqja e pyllit e po ashtu ne mënyrë te gabuar është bere cilësimi i veprës penale sipas paragrafëve.

Gjykata pas shqyrtimit të aktakuzës, duke u bazuar në nenin 235 par 4, të KPPRK-së dhe konstatimeve te të metave të saj, përmes parashtresës së datës: 01.03.2024, ka kërkuar nga prokuroria qe të bëhet plotësimi i aktakuzës, sa i përket çështjeve se cila është adresa e sakte te akuzuarit si dhe vlera e demit si element qe duhet përmbushur për veprën penale ndaj të akuzuarit I.S, po ashtu ka kërkuar nga ana e Prokurorisë së Shtetit qe në afat prej 15 ditësh të bëhet plotësimi i aktakuzës PP/II.nr. 5144/2020 të datës: 27.11.2020.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, edhe pse ka pranuar në mënyrë të rregullt me datë: 06.03.2024, kërkesën për plotësim të datës 01.03.2024, e njëjta nuk ka plotësuar aktakuzën e lartcekur.

Andaj gjykata nga të lartcekurat, duke u bazuar në nenin 235 par 4, të KPPRK-së, si ka kërkuar plotësimin i e aktakuzës, duke kërkuar qe brenda 15 ditëve Prokurori te beje plotësimin e saj, mirëpo Prokuroria Themelore ne Prishtine nuk ka bërë plotësimin e aktakuzës PP/II.nr. 5144/2020 të datës: 27.11.2020, sipas kërkesë së gjykatës, andaj gjykata ne harmoni te nenit 235 par. 4 si dhe të nenit 357 par. 1 nen par. 1.3 te KPPRK-ës, ka vendosur qe të hedh aktakuzën ndaj të pandehurit I.S për shkak të mosplotësimit të aktakuzës, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me këtë çështje e ka hedhë poshtë aktakuzën të pa plotësuar dhe të pa korrigjuar, konform nenit 235 par.4 lidhur me nenin, 357 par 1 nen par 1.3 te KPPRK-ës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimin lidhur me udhëzimin ne palës së dëmtuar në kontest juridiko civil është mbështetur në nenin 462 par 3 të KPPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedure penale e ka bazuar në neni 453 par 1 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I
PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2020:167339, 04.04.2024**

Bashkëpunëtori Profesional
Asdren Selmani

Gjyqtari i vetëm gjykues
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKË: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 3 (tri) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.